



"për një Shqipëri më të mirë"

"për bashkimin e vërtetë të kombit"

"për mbarëvajtjen e atdheut"



NGA PËRSHËNDETJA E SHOKUT BRUNO MORAND, KRYETAR I KOLEKTIVIT MILITANT KOMUNIST TË FRANCËS

Të dashur shokë,

Në fillim dëshiroj të falënderoj Partinë Komuniste të Shqipërisë për nderin që na bëri ne komunistëve francezë, duke na ftuar për të marrë pjesë në veprimtaritë kushtuar shokut Enver Hoxha në 100 vjetorin e lindjes së tij.

Njëqind vjet më parë, kur Enver Hoxha u lind në Gjirokastrë, prindërit e tij nuk e imagjinonin që djali i tyre i vogël do të bëhej një nga bijtë më të shquar të popullit shqiptar përkrah Heroit Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeut dhe një nga udhëheqësit më të mëdhenj të lëvizjes komuniste ndërkombëtare përkrah Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit.

Populli shqiptar, klasa e tij punëtore, fshatarësia e tij punonjëse dhe intelektualët e tij të ndershëm e njohin fare mirë madhështinë e veprës që Enver Hoxha ka kryer për popullin e vendin e tij në të gjitha fushat: ekonomike, politike, sociale e kulturore dhe për çështjen kombëtare e mbrojtjen e Shqipërisë.

Unë si komunist i Francës dëshiroj të ndalëm në anën tjetër të veprës së Enver Hoxhës dhe pikërisht në kontributin e tij politik e teorik me vlerë universale. Për të gjithë komunistët e botës kontributi më i madh i shokut Enver Hoxha në revolucion është zbatimi e mbrojtja e papërkulur e teorisë marksiste-leniniste dhe lufta e tij e pandërprerë kundër të gjitha deviacioneve, që synonin heqjen e përmbajtjes revolucionare të saj.

Beteja e parë me dimensione ndërkombëtare që zhvilloi Enver Hoxha kundër revizionizmit është lufta kundër titizmit. Enver Hoxha hodhi poshtë në fillim pretendimet e Titos për ta vënë PKSH nën tutelën e PK të Jugosllavisë. Në të njëjtën kohë, kundërshtoi presionet titiste për ta vënë luftën antifashiste nacionalçlirimtare të popullit shqiptar nën influencën e anglo-amerikanëve. Ai hodhi poshtë pas çlirimit tentativën e Titos për aneksimin e Shqipërisë nga Jugosllavia dhe luftoi kundër qëndrimeve të tij antimarksiste për çështjen e vetëvendosjes së Kosovës. Përkrah Stalinit, Enver Hoxha vuri në dukje falsitetin e „socializmit“ vetadministrues në Jugosllavi, duke treguar qartë natyrën e tij kapitaliste dhe duke dhënë kështu një kontribut teorik të rëndësishëm në fushën e ekonomisë politike të socializmit shkencor dhe një ndihmesë të madhe politike në lëvizjen komuniste ndërkombëtare.

Beteja e dytë, mundet dhe më e vështira, është ajo që Enver Hoxha ndërmori kundër revizionizmit modern hrushovian. Pas Kongresit të 20-të të Partisë Komuniste të BS, në të cilën u ndërmorën sulme skandaloze kundër Stalinit, u bë shpejt e qartë që PK e BS kishte rënë në kthetrat e një klike komplotistësh trockistë të udhëhequr nga Nikita Hrushovi. Që atëherë, duke kuptuar pasojat e rënda që do të kishte, Enver Hoxha mori mbi vete përgjegjësitë



e një komunisti të shquar dhe u angazhua në demaskimin e kësaj tradhtie hapur, „pa dorashka“, para gjithë lëvizjes komuniste botërore.

Njëra nga ofensivat e mëdha të kësaj lëvizjeje që atëherë ishte Konferenca e 81 Partive Komuniste më 1960, në Moskë. Atje, përpara përfaqësuesve të Partive Komuniste të gjithë botës, Enver Hoxha denoncoi drejtpërdrejt kreun e orkestrës revizioniste, Nikita Hrushovin. Duke denoncuar sulmet e kësaj klike kundër Stalinit të madh, Enveri i përplasi në fytyrë, ballëpërballë tradhëtareve fjalët lapidare: **“Veprën e shquar e të pavdekshme të Stalinit duhet ta mbrojmë të gjithë. Kush nuk e mbron, është një oportunist e një lake!”**. Në të njëjtën konferencë, Enver Hoxha denoncoi konceptin oportunist të „bashkekzistencës“ paqësore të propaganduar nga Hrushovi duke argumentuar se ajo çon në kapitullimin para imperializmit amerikan dhe në bashkëpunim me të në dëm të luftërave për çlirim.

Enver Hoxha ka meritën e madhe që kuptoi e denoncoi qëllimet e vërteta të udhëheqjes së re revizioniste të PK të BS, duke e ditur se ato do të çonin në likuidimin e diktaturës së proletariatit e restaurimin e kapitalizmit në shërbim të borgjezisë së re monopoliste të shtetit e të shtresave të tjera të nomenklaturës. Në një letër të hapur drejtuar anëtarëve të PK të BS në tetor 1964, Enver Hoxha shkruante **se tezat mbi të ashtuquajturën parti të gjithë popullit e shtet të gjithë popullit janë një mashtrim i madh. Ato nuk kanë asgjë të përbashkët me marksizëm-leninizmin dhe nuk shërbejnë veçse për të përgatitur terrenin për restaurimin e kapitalizmit. Historia i ka dhënë të drejtë Enverit.**

Në vijim duke evidentuar rolin e Enver Hoxhës lidhur me demaskimin e revizionizmit evrokomunist dhe për domosdshmërinë e revolucionit proletar e të diktaturës së proletariati në ndërtimin e socializmit, shoku Bruno Morand theksoi se si internacionalist konsekuent, Enver Hoxha inkurajoi, mbështeti e këshilloi komunistët e vërtetë në botë në luftën e tyre kundër revizionizmit dhe për rindërtimin e partive të tyre komuniste marksiste-leniniste.

Shokë!

Është për të gjitha këto arsye që Enver Hoxha meriton mirënjohjen dhe nderimin e komunistëve në të gjithë botën. Për këtë, unë do të dëshiroja të shtoj në emër të shokëve të mi të Kolektivit Militant Komunist të Francës se në qoftë se komunistët duhet të nderojnë shokun Enver Hoxha, kjo nuk është vetëm në raport me historinë e shkuar, por dhe në raport me historinë tanishme dhe situatën me të cilën ne konfrontohemi sot.

Bota është futur aktualisht në një situat të rrezikshme, e provokuar nga kriza e përgjithshme e sistemit imperialist. Kontradiktat objektive të revolucionit po piqen, por fatkeqësisht lëvizja komuniste është e dobët organizativisht e ideologjikisht dhe shpesh në këto kushte forcat komuniste janë të çorientuara, veprojnë sipas linjash konfuze, të gabuara. Në veprën e tij madhore “Imperializmi dhe Revolucioni”, Enver Hoxha i ka bërë një analizë shkencore pa ekuivoqe sistemit të epokës sonë. Ai ka përcaktuar qartë, që prej një çerek shekulli më parë,



rivalitetin midis imperializmit amerikan dhe socialimperializmit sovjetik si një rivalitet imperialist, sikurse ka treguar me fakte që Kina aspron të bëhet një superfuqi e aftë të rivalizojë me të tjerët. Të gjitha ngjarjet e sotme tregojnë që analizat e Enver Hoxhës janë sot më të drejta e më aktuale se kurrë! Përballë kësaj situatë, ai ka përcaktuar përgjegjen e vetme të mundshme për komunistët: rindërtimin e partive të tyre mbi bazën e marksizëm-leninizmit, përgatitjen e revolucionit, mbështetjen e popujve në luftën kundër imperializmit, cilido qoftë ai. Dhe mbi të gjitha, nuk duhet mbështetur në një imperializëm për të luftuar një tjetër. Këtë direktivë të madhe të shokut Enver Hoxha komunistët kanë detyrë ta zbatojnë në praktikë, pa kthim.

Shokë!

Sot, shoku ynë i dashur, Enver Hoxha, nuk është fizikisht midis nesh, por mësimet e tij na ndriçojnë e na udhëheqin. Mësimet që ai na ka transmetuar janë të pavdekshme dhe na takon ne t'i zbatojmë. Ai jeton në zemrat tona, në mendjen e në praktikën tonë.

- Të mbrojmë pa lëkundje teorinë e Maksit, Engelsit, Leninit e Stalinit!
- Të luftojmë kapitalizmin, imperializmin dhe revizionizmin!
- Të zbatojmë internacionalizimin proletar!
- Të rrojnë përgjithmonë në historinë e njerëzimit vepra, mësimet dhe emri i Enver Hoxhës!